



Drejtoria e Arsimit  
Nr.07-Zyrtarisht  
09.03.2021

Në bazë të nenit 64, paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018. Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Deçan, shpallë këtë:

### KONKURS


Për plotësimin e vendeve të punës

| Nr. | Niveli, Shkolla                                               | Pozita                         | Vend i Lirë /Me kohë të caktuar / Zëvendësim | Numri i pozitave |
|-----|---------------------------------------------------------------|--------------------------------|----------------------------------------------|------------------|
| 1   | Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Rexhep Kadrijaj" Rastavic    | Mësimdhënës i/e Edukimit Fizik | Vend i Lirë                                  | 1                |
| 2   | Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Jusuf Gërvalla" Prapaqan     | Mësimdhënës i/e Matematikës    | Kohë të Caktuar<br>(16 Orë)                  | 1                |
| 3   | Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Bajram Curri" Strelc i Epërm | Punëtor Teknik                 | Vend i Lirë                                  | 1                |
| 4   | Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Isa Boletini" Isniq          | Punëtor Teknik                 | Vend i Lirë                                  | 1                |
| 5   | Shkolla e Mesme Tekniket "Tafil Kasumaj" Deçan                | Punëtor Teknik                 | Vend i Lirë                                  | 1                |

**Kriteret e kualifikimit për Punëtor Teknik:** Shkollimi Bazik.

#### I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit;
- Rezumeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta - kopje);
- Diploma e kualifikimit e noterizuar;
- Trajnime (nëse ka);
- Vërtetimin për përvojën e punës (nëse ka);
- Certifikata që nuk jeni nën hetim;
- Certifikata e lindjes;
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHT.



II. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Për intervistë do të ftohen vetëm kandidatët, të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura, në mungesë kualifikimi i përafërt.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje, (kualifikimet universitare duhet të jenë të noterizuara), dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkojnë me rastin e intervistës.

Formularin i Aplikimit për Punësime shkarko këtu: <https://kk.rks-gov.net/decan/sherbimet/formulare/>.

**Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në faqen zyrtare të komunës, duke filluar nga data e publikimit më: **09.03.2021** më datën: **23.03.2021**.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes zyrës së DKA-së Nr. 52 , në objektin e Komunës së Deçanit.

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, do të zëvendësohet në vartësi të liritimit real të vendit të punës.



**Ma. sc. Bekim Vishaj**